



Në tenderin e fundit të dhënë për asfaltimin e rrugëve me 4 korsi "Shqipëria" dhe "Haradin Bajrami" të datës 15.05.2013, taksapaguesve të Komunës së Lipjanit u ka kushtuar 628,911.00 euro më shumë se oferta me çmimin më të ulët e ofruar nga kompania tjetër

SHOQËRIA CIVILE AKUZON KOMUNËN PËR THELLIM BORXHESH

## YAHR: 600 mijë euro më shtrenjtë rrugët me katër korsi

Arian Duriqi

LIPJAN, 19 QERSHOR – Komuna e Lipjanit po rrezikon të shtojë borxhet e krijuara nga 2 në 4 milionë euro dhe krejt kjo për shkak se po jepen punë që po kushtojnë më shtrenjtë. Së fundi, ndërkaq, Bekim Krasniqi, drejtor ekzekutiv në Asociacionin Rinor për të Drejtat e Njeriut – YAHR ka akuzuar komunën që drejtohet nga Shukri Buja se po thellon borxhet në forma të ndryshme. Krasniqi ka gjetur se në tenderimin e fundit rreth ndërtimit të dy rrugëve me katër shirita brenda qytetit Komuna e Lipjanit ka dhënë punë për operatorin që ka qenë më i shtrenjtë për rreth 600 mijë euro.

"Organizata Joqeveritare YAHR shpreh shqetësimin për jomenaxhimin e mirë të parasë publike. Sepse, në tenderin e fundit të dhënë për asfaltimin e rrugëve me 4 korsi "Shqipëria" dhe "Haradin Bajrami" të datës 15.05.2013, taksapaguesve të Komunës së Lipjanit i ka kushtuar 628,911.00 euro më shumë se oferta me çmimin më të ulët, e ofruar nga kompania tjetër. Fitues i këtij tenderi është kompania "Bageri" nga Ferizaj me ofertën prej

2,888,108.00 euro, ndërsa konsorciumi "Baskom-Eskavator" me ofertën me të ulët prej 2,289,197.36 eurosh është eliminuar nga gara me arsyetimin e vetëm se kompania "Baskom" nuk e ka lajmëruar me kohë konsorciumin me kompaninë "Eskavator" nga Ferizaj", ka thënë në akuzën e tij, Krasniqi. Ky ka vazhduar të akuzojë autoritetet komunale se po hyjnë në obligime buxhetore nga viti në vit, derisa sipas tij, ky është një rezultat i punëve që po jepen pa asnjë mbulesë financiare.

"Komuna e Lipjanit për vitet e ardhshme do të hyjë në obligime buxhetore 2,333,108 euro, sepse për këtë vit 2013 me planifikimin buxhetor janë paraparë vetëm 500 mijë euro për rrugët katërshiritëshe dhe kur t'i shtohen obligimet tjera kontraktuese të bartura nga vitet e kaluara do të thotë se Komuna e Lipjanit është në obligime për vitet e ardhshme afër 4 milionë euro. Ndaj, YAHR-i reagon dhe fton kryetarin, Drejtorin e Prokurimit dhe autoritetet e tjera që të kenë kujdes në menaxhimin sa më të mirë të parasë publike", është shprehur Krasniqi. Ndërkohë që, edhe opozita e kësaj

komune borxhet në fjalë po i sheh si kontraktim të punëve pa mbulesë financiare. Për më tepër, Sefer Tasholli (LDK), ka vlerësuar se borxhet e mëdha e kanë sjell Komunë para një situatë kur kërkohet zgjidhje emergjente. "Ekzekutivi ka nënshkruar kontrata pa zotim mjesh dhe kësajsoj janë bërë edhe shkelje ligjore, për faktin se janë shpallur punë pa mbulesë financiare", ka thënë Tasholli.

Mirëpo, Hasan Luma, shef në Zyrën e Informacionit Publik në Lipjan është kundërpërgjigjur se pohimet e OJQ-së YAHR kanë nisur shpesh të devijojnë dhe se së shpejti do të ketë edhe qëndrim zyrtar rreth asaj se a ka të drejtë kjo OJQ apo jo në akuzat e vazhdueshme që bën drejt Komunës.

"OJQ YAHR ka nisur të akuzojë pa bazë dhe pa asnjë kriter e argument. Sipas dokumentacionit përzgjedhja operatorit për rrugët katërshiritëshe ka mbështetur të plotë ligjore dhe se shumë shpejt do të dilet me analizën e tenderimit në fjalë dhe me kundërpërgjigjen faktike për OJQ-në e Krasniqit", ka thënë Luma.

© KOHA Ditore

## KEDS-i shkyç konsumatorët edhe për borxhe

dua  
Fa

Bejtulla

RAHOVEC, 19 QERSHOR – Komuna e Rahovec është në pritje të një kërkesë me seancë të jashtëzakonshme, në të cilën do të tohet ndërpërprerja e ndërtimit të Fabrikës së Bujve në Bellacerkë. Komiteti i Përbashkët i Feim Feim Komitetit të Policisë së Rahovec, të mërkurë.

Ai ka thënë se në kështilltarëve janë ministritë kom

fshatit.

Arsyeja e mbledhjes së komiteteve sipas kësaj shprehjeje të punimet të ndërprerjes së një zgjidhjeje të "Kërkesa e tillë diskutohet në KP të konform Ligjit të lokaliteteve dhe të Statutit të Komunës ka qenë sugjerim kryesuesit të mbledhjes së Xhemajli Haxhimiri për kërkesën e Nahit KPF-së nga radhë e himustafa i ka

banor  
përfsh

Avni D

SHTËRPECË, 19 QERSHOR – Komuna e Shtërpçës më të mirë mundave dhe i qytetarët demokratikë. Qytetarët dhe pjesë në këtë debatë përcaktojnë në përgjithësi munduar që të qytetare sa më të transparente në vlerësimet e megjithatë ka nevojë Komunarët kanë të fton qytetarët vendimmarrjeje.